



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
 AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
 AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
 ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. 03-03/DPK
 Nr. I faq. 02
 Broj stranica
 Nr. pages

Nr. Prot. 01-1842/16
 Br. Prot. Prot No.
 Data 24.05.2016
 Datum Date
 PRISHTINE



Republika e Kosovës
 Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
 AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
 ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATË/A:	24/05/2016
REFERENC-Ë:	AKK- DPK- DPKPP-03-03/1726/16
PËR/ZA/TO:	z. Zekrija DUSHI Drejtor i Prokurimit në Radio Televizionin e Kosovës
CC:	z. Mentor SHALA Drejtorit i Përgjithshëm i Radio Televizionit të Kosovës
NGA/OD/FROM:	Hasan PRETENI Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me tenderin: "Paisje për integrimin e rrjetës dhe zhvillimin e montazhës në TV dhe Radio"

I nderuar z. Dushi,

Në mbështetje të nenit 142 (par. 3) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 5 (par. 1, nënpar. 1.1.) dhe 21 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, nenit 8 (par. 4), 9 (par. 1, nënpar. 1.6), 12 (par. 2) dhe 19 (par. 1, nënpar. 1.6) të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, si dhe të nenit 23 të Rregullores nr. 01/2014 së Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, lidhur me Tenderin: "Paisje për integrimin e rrjetës dhe zhvillimin e montazhës në TV dhe Radio" me numër prokurimi: RTK-T 16 141 121, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

OPINION

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet Kontraktues që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme për evitimin e shkeljeve të evidentuara në lidhje me Tenderin me titull: "Paisje për integrimin e rrjetës dhe zhvillimin e montazhës në TV dhe Radio" me numër prokurimi: RTK-T 16 141 121, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr. 04-L/042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

A r s y e t i m

Autoriteti Kontraktues Radio Televizioni ka iniciuar Procedurën e Prokurimit me titull: **“Paisje për integrimin e rrjetës dhe zhvillimin e montazhës në TV dhe Radio”** me numër prokurimi: RTK-T 16 141 121, e cila është publikuar në faqen elektronike të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik më datë 06/05/2016. Për këtë aktivitet të prokurimit Autoriteti Kontraktues-RTK ka paraparë procedurë të hapur për furnizim.

Agjencia Kundër Korrupsion ka identifikuar këtë aktivitet të prokurimit si lëndë për trajtim. Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit në dispozicion për këtë procedurë të prokurimit në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit, Agjencia kundër Korrupsion ka konstatuar se Autoriteti Kontraktues- RTK e ka formuluar specifikimin teknik në kundërshtim me ligjin në fuqi për Prokurimin Publik në Kosovës.

Gjatë shfletimit dhe analizës së Dosjes së Tenderin Agjencia ka konstatuar se tek Aneksi I Specifikimet Teknike të Detyrueshme të Dosjes së Tenderit, Autoriteti Kontraktues ka kërkuar artikuj duke iu referuar emrave të prodhuesve.

Bazuar në legjislacionet në fuqi për Prokurim Publik me përcaktimin e emrit të prodhuesit të këtyre mallrave, mund të favorizohen prodhuesit e caktuar dhe në të njëjtën kohë diskriminohen prodhuesit tjetër. Autoriteti Kontraktues mund të kërkojë që produkti të jetë i kualitetit të lartë dhe mund të referohet një standardi vendor, European ose ndërkombëtar, por nuk lejohet assesit të kërkojë emërtimi i të këtyre mallrave.

Njësia kërkuese pranë Autoritetit kontraktues duhet të ketë kujdes që me rastin e formulimit të specifikimeve teknike të mos formulojë specifikime favorizuese për prodhues të caktuar e në të njëjtën kohë të diskriminojë Operatorët tjerë ekonomik.

Për autoritetin kontraktues është veçanërisht i ndaluar që të hartojë specifikime teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik.

Veprimet e Autoritetit Kontraktues konsiderojmë se bien ndesh me nenin 7 Barazia në trajtim dhe jo Diskriminim; Nenin 27 Dosja e Tenderit si dhe Nenin 28 Specifikimet teknike; të Ligjit nr. 04-L/042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 .

Konsiderojmë se shkelje të tilla nuk duhet lejuar në procedura të prokurimit, andaj Agjencia Kundër Korrupsion rekomandon anulimin e kësaj Procedure të Prokurimit dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues që t'i shmang dhe të mos i përsëris praktikat e tilla në të ardhmen.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !

